



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

PROCESVERBAL

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) në rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) organizoi mbajtjen e mbledhjes të KKShC-së, ditën e martë, datë 15.11.2022, ora 10:30 në ambjentet e Kryeministrisë.

Anëtarë të pranishëm ishin:

Për anëtarët përfaqësues të institucioneve publike:

1. Znj. Ogerta Manastirliu – *Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*
2. Znj. Milva Ekonomi (e ftuar) – *Ministër i Shtetit për Standartet e Shërbimeve*
3. Znj. Romina Kacorri
4. Z. Fran Brahimi
5. Z. Oltion Pengu
6. Znj. Megi Fino
7. Znj. Denada Seferi
8. Znj. Albana Celaj

Për anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile të Këshillit:

1. Z. Armando Bala
2. Znj. Fabiola Laço – Egro
3. Z. Indrit Seferi
4. Z. Vladimir Thanó
5. Z. Andi Rabiaj
6. Z. Dritan Sakuta
7. Znj. Ermelinda Mahmutaj
8. Znj. Ilda Pisha
9. Z. Andi Rabiaj
10. Z. Xhimi Vila
11. Znj. Mirela Juka

Përfaqësues nga AMShC:

1. Z. Andi Kananaj – *Drejtor Ekzekutiv*
2. Z. Erion Banushi
3. Znj. Eniana Koçiaj
4. Znj. Andia Ndreka
5. Znj. Paula Bero



KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Përfaqësues nga Kryeministria:

1. Znj. Oriana Arapi

Mbledhjen e KKShC-së, me kuorumin e nevojshëm, e çeli Kryetarja e Këshillit, dhe njëkohësisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, **Znj.Manastirliu**. Pas falenderimeve për punën e bërë nga Këshilli gjatë vitit 2022, Znj.Manastirliu vijoi me prezantimin e çështjeve të rendit të ditës si më poshtë vijon:

1. Fjala përshëndetëse nga Kryetarja e KKShC-së, Znj.Ogerta Manastirliu
2. Fjalë përshëndetëse dhe prezantimi i mundësive aktuale për bashkëpunim mes shoqërisë civile dhe nismës për Partneriten për Qeverisjen e Hapur (OGP), Znj.Milva Ekonomi.
3. Prezantim mbi udhëzimet e DG NEAR¹ për mbështetjen e Bashkimit European për shoqërinë civile 2021-2027.
4. Diskutime mbi ngritjen dhe ndarjen e grupeve të punës së KKShC-së.
5. Propozime për kalendarin e aktiviteteve të KKShC-së.

Hapja e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin European më 19 korrik 2022, përveçse arritje për shoqërinë shqiptare, përbën, sipas Kryetares, edhe përgjegjësi politike dhe morale për të shtuar angazhimet bashkëpunuese mes institucioneve dhe aktorëve publik e privat. Në këtë kuadër ka nisur edhe angazhimi me gjithë grupet e punës, institucionet qendrore, bizneset, akademinë, media etj. Shoqëria civile në këtë proces, është e domosdoshme dhe e pazëvendësueshme, prandaj një mekanizëm i tillë kolegjal dhe autonom siç është KKShC-ja, duhet të jetë shumë aktiv në gjithë procesin. Në përfundim të fjalës hapëse, znj.Manastirliu shtoi gjithashtu se qeveria shqiptare është angazhuar tashmë me ngritjen e grupeve të punës me përfaqësues të shoqërisë civile për të shtyrë agjendën e përbashkët Shqipëri-BE.

10:45 - Mbledhja vazhdoi me çështjen e dytë të rendit të ditës, me prezantimin e punës dhe nismave të Ministrisë së Shtetit për Standartet e Shërbimeve. Hapësirat dhe mundësitë për bashkëpunim mes nismave qeveritare konkretisht Ministrisë së Shtetit dhe Standartet e Shërbimeve dhe shoqërisë civile, u prezantuan nga vetë Ministria **Znj.Milva Ekonomi**, e cila u ndal kryesisht në parimet e qeverisjes së mirë dhe në nismën shumëpalëshe të partneritetit për qeveri të hapur (OGP²).

Duke u ndalur tek OGP-ja Znj.Ekonomi theksoi se ky partneritet është një rrjet global në të cilin përfshihen anëtarë në nivel kombëtar dhe lokal dhe mijëra organizata të shoqërisë civile. Shqipëria si pjesë e këtij partneriteti, dhe për të siguruar rolin e OShC-ve në politikbërje dhe në mbikëqyrjen e qeverive,

¹ DG NEAR qendron për: “Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme për Negociatat e Fqinjësisë dhe Zgjerimit”

² OGP qendron për: Open Government Partnership ose Partneriteti për Qeveri të Hapur.



KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

bashkë-krijon plane veprimi me hapa konkretë, implementon, raporton etj., për një gamë të gjerë çështjesh. Në këtë kuadër Znj. Ekonomi ftoi të gjithë anëtarët e KKShC-së dhe veçanërisht përfaqësuesit e shoqërisë civile që të jenë tepër të zëshëm në procesin e politkërjes dhe informacioneve të përcejlla p.sh. për “open data”. Ajo u ndal në katër sugjerime konkrete:

1. Të forcohet lidhja e këtij organi kolegjal, KKShC-së me nismën OGP, dhe shoqëria civile të japë sugjerimet për planet Strategjike të Komitetit.
2. Të dhënat për “open data” të vijnë, kur të jetë mundësia, nga shoqëria civile.
3. Ndryshimet dhe sugjerimet nga shoqëria civile të reflektohen në Komitet.
4. Tema dhe çështje të rëndësisë globale dhe rajonale, si ekonomia e gjelbër, siguria, inteligjenca artificiale, qeverisja e hapur etj., është mirë që momentalisht të reflektohen dhe përkthehen në angazhime edhe nga shoqëria civile, sepse po ndërmerren nisma konkrete për Ballkanin Perëndimor.

10:55 – Mbledhja e Këshillit vazhdoi me pikën e tretë në rendin e ditës, që ishte prezantimi i publikimit të dytë të Udhëzimeve për mbështetjen e shoqërisë civile në Shqipëri, për periudhën 2021-2027. Prezantimi u bë nga **Znj. Natasha Mazari**, Koordinatore Kombëtare e TASCOS për Shqipërinë, e cila pas falenderimeve për punën e bërë nga Këshilli dhe bashkëpunimin me AMShC-në dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, u ndal gjerësisht në: (i) mbështetjen e Këshillit Evropian për Shqipërinë, dhe konkretisht për shoqërinë civile; (ii) mënyrën se si, për çfarë dhe për kë do jepet kjo mbështetje; dhe (iii) mënyrat e bashkëpunimit të KKShC-së dhe AMShC-së duke u bazuar tek këto udhëzime. Mbështetja e BE-së për shoqërinë civile aspiron drejt arritjes së tre qëllimeve kryesore:

1. Krijimi i një mjedisi mundësues për shoqërinë civile dhe realizimin e aktiviteteve të tyre
2. Fuqizimi i bashkëpunimit dhe partneritetit midis OSHC-ve.
3. Përforcimi i kapaciteteve të OSHC-ve dhe rritja e qendrueshmërisë së OSHC-ve për realizimin e aktiviteteve të tyre.

Sa i përket rolit të KKShC-së në procesin e angazhimit të shoqërisë civile Znj. Mazari theksoi se Këshilli duhet të jetë shumë aktiv gjatë procesit të zgjerimit; duhet t’u japë hapësirë dhe zë organizatave aktive të shoqërisë civile qoftë në Këshill ashtu edhe në prezantimin e tyre në rajon (si histori suksesi p.sh.); dhe Këshilli të sjellë në mënyrë periodike prezantime të punës së OSHC-ve.

Raportimet e mëparshme dhe ato vjetore, nëse shihet e nevojshme, mund t’i ndajmë e t’i bëjmë publike dhe të aksesueshme edhe në faqet e Këshillit apo të AMShC-së, sugjerim ky i cili u mbështet nga Kryetarja dhe anëtarët e Këshillit.



KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Në lidhje me përfshirjen e OShC-ve në fazat e konsultimeve, Z.Kananaj u ndal duke theksuar se nga muaji janar 2023, Agjencia do nisë në nivel kombëtar takime konsultuese për Udhërrëfyesin e ardhshëm, takime këto të cilat do mbështeten në Udhëzimet e 'DG NEAR'.

Znj.Manastirliu, pas falenderimeve dhe komplimentimit për punën e bërë nga TASC0 3, dhe pasi theksoi rëndësinë e mbështetjes së BE-së për shoqërinë civile, sugjeroi që dokumenti t'i përcillet gjithë organizatave të shoqërisë civile dhe të publikohet në faqen zyrtare të AMSHC-së.

11:25 - Këshilli vazhdoi me çështjen e radhës në lidhje me procedurat e zgjedhjes së anëtarëve të shoqërisë civile në Këshill, çështje e cila u prezantua nga **Z.Andi Kananaj**, Drejtor Ekzekutiv i AMSHC-së.

Z.Kananaj bëri me dije anëtarët e Këshillit për mbarimin e afatit të anëtarësisë së disa prej anëtarëve nga shoqëria civile me datë 26 dhjetor 2022, të cilët janë:

Armando Bala
Ermelinda Mahmutaj
Shpëtim Myrto
Dritan Sokuta
Fabiola Egro
Andi Rabija
Artrida Ferketi, dhe
Indrit Seferi

Më pas Z.Kananaj prezantoi rolin e AMSHC-së si Sekretariat Teknik i KKShC-së, në këtë proces duke u ndalur tek: (i) procesi i kandidimit të personave në rang Republike nga të gjitha OShC-të e interesuara; (ii) procesin e publikimit të thirrjes për anëtarët e rinj të KKShC-së; dhe (iii) procesin e votimit e më pas të përzgjedhjes.³

Në lidhje me votimin e anëtarëve të rinj, Znj.Manastirliu theksoi se votimi duhet të jetë sa më transparent dhe të ndjekë të gjitha hapat e procedurat e nevojshme, prandaj është shumë e rëndësishme që ky informacion t'i shkojë të gjithë organizatave të shoqërisë civile. Ajo mbështeti gjithashtu propozimin e Z.Kananaj për të patur nje komision teknik për procedurat e zgjedhjeve, strukturimin e të cilit sugjeroi ta bënte Z.Thano në bashkëpunim edhe me AMSHC-në. Në përfundim u hodh në votim dhe u dakordësua në unanimitet që procesi i zgjedhjes së kandidatëve të rinj të bëhet brenda muajit dhjetor, 20 dhjetor 2022, në mënyrë që mandati i anëtarëve të rinj të fillojë menjëherë një ditë pas përfundimit të mandatit, pra më 27 dhjetor 2022.

³ Bashkëngjitur këtij procesverballi mund të gjeni vendimin e Komisionit të Nominuar të Zgjedhjeve pranë Këshillit, në lidhje me kriteret për kandidatët dhe dokumentacionin mbështetës – Shtojca I.



KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Pas prezantimit të Z.Kananaj, **Znj.Fabiola Egro** u ndal tek rëndësia e Udhëzuesit të prezantuar nga Znj.Mazari, duke theksuar se Udhëzuesi është një material shumë i mirë jo vetëm për ne por edhe për tre target grupet që u përmendën që janë donatorët, autoritetet lokale dhe organizatat. Përveç këtij mekanizmi që ne kemi në dorë tani dhe që mund të jetë për informim dhe ndërgjegjësim për të gjitha grupet Znj.Egro shtroi për diskutim pyetjen nëse Udhëzuesi i jep hapsirë OshC-ve që të jenë pjesë e procesit të monitorimit dhe të jenë pjesë e grupeve të punës për këtë proces.

Në dijeni të Znj.Mazari nuk ka grupe të tilla pune në të cilat OShC-të mund të monitorojnë.

Ndërkohë Kryetarja e Këshillit shtoi se tryeza e këtij Këshilli, është forumi më i lartë i transparencës dhe i llogari-dhënies në nivel kombëtar, dhe për rrjedhojë grupet e punës që ne do të ngremë në këtë Këshill, mund të bëjnë monitorimin në bazë të elementëve të ndryshëm që ka Udhëzuesi. Pra, ky udhëzues e ka mbaruar detyrën në momentin kur bëhet prezantimi në Këshill.

11:30 – Dy çështjet e fundit të rendit të ditës në lidhje me ndarjen e grupeve të punës dhe propozimin e kalendarit të aktiviteteve të Këshillit u prezantuan dhe u diskutuan nga **Z.Vladimir Thano**, Z/Kryetar i Këshillit. Propozimet për ngritjen e grupeve të punës⁴, të përpiluara dhe konsultuara më parë nga anëtarët e Këshillit për shoqërinë civile, janë si më poshtë vijon:

1. Ngritja e e nje grupi pune mbi ecurinë dhe rekomandimet mbi procesin e antarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe procesin *screening* si dhe adresimin e nevojave që dalin nga ky proces drejt Këshillit në lidhje me “Demokratizimin, shtetin e së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimin në BE.”.
2. Ngritja e një grupi pune në lidhje me lehtësimin e komunikimit dhe efikasitetit të propozimeve në mbledhjen e prioriteteve.

Pas prezantimeve, dhe para fillimit të diskutimeve nga të pranishmit e tjerë, Kryetarja e Këshillit bëri disa komente në lidhje me ndarjen e grupeve të punës dhe kalendarin e aktiviteteve si më poshtë vijon:

“Lidhur me propozimin për ngritjen e grupeve të punës dhe sigurisht edhe për kalendarin e aktiviteteve vjetore më lejo të them që unë do të sugjeroja që ky kalendar aktiviteteve të ishte i shtrirë për gjatë gjithë vitit 2023. Përsa i përket seminareve dhe aktiviteteve që janë specifikuar mendoj se është shumë ambicioz, e para sepse brenda janarit të vitit 2023 nuk mendoj se do jemi në gjendje të hartojmë një plan që është në proces dhe të përfundojë në 31 janar 2023. Mendoj se është ambicioz nga pamja e afateve dhe jo e detyrave, sepse duhet të kuptojmë që jemi në një proces përzgjedhesh anëtarësh për Këshillin dhe më pas këta anëtarë të rinj që fillojnë mandatet në 27 dhjetor 2022 duhet të

⁴ I gjeni të bashkëngjitura në Shtojcën II



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

kenë kohën e tyre për t'u njohur me proceset dhe detyrat e funksionimit të shoqërisë civile. Së treti këta anëtarë që vijnë duhet që të jenë pjesë e grupeve të punës dhe të zhvillojnë punën për këtë gjë.

Sa i përket ngritjes së grupeve të punës dhe pikës së demokratizmit, shteti së drejtës, të drejtat e njeriut dhe integrimi në BE duhet të ngihet një grup pune që të ndjekë të gjithë raportet që organizatat e shoqërisë civile prodhojnë ose përpilojnë.

Së dyti, përsa i përket prezantimeve që besoj do të jenë pjesë e kapitujve që prezantohen në BE si pjesë e agjendës për negociatat, ne do të kemi mundësinë në kuadër të kapitullit 23 që të shtojmë një grup të Ministrisë së Drejtësisë, kryesuar nga vetë Ministria, dhe KKShC si përfaqësuese. Besoj se jeni dakort që raportimi të bëhet nga zv/ministrja znj. Seferi për pjesën e shoqërisë civile. A jeni dakort? Po jeni dakort dhe sigurisht një draft i këtij prezantimi të mund të qarkullojë tek ju.

Së treti, përsa i përket grupit të punës për lehtësimin e komunikimit dhe efikasitetit në mbledhjen e prioriteteve, jam në dakortësi të plotë me ju që këto mbledhje edhe për arsye transparence dhe llogaridhënie, por mbi të gjitha për arsye të njohjes dhe komunikimit me të gjithë dhe tejçimit të informacionit, të mund të transmetohen drejtpërdrejtë ose si përmbledhje në trajtën e *live-it* të të gjithave rekomandimeve, gjetjeve dhe prezantimeve që bëhen nga KKShC.

Së fundmi, përsa i përket pikave që ju keni vendosur, duhet të kemi parasysh që ne kemi një Udhërrëfyes që është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Udhërrëfyesi është deri në dhjetor 2023, ky Udhërrëfyes përmban shumë pika strategjike brenda së cilave janë edhe aktivitete që keni parashtruar këtu. Për rrjedhojë do të sugjeroja, që të mos dalim me strategji mbi strategji dhe që zbatimi i Udhërrëfyesit të jetë plani kryesor i veprimit sepse ai i ka të gjitha këto pika. Përgjatë 2023 dhe më pas ku ne do të kemi fillimin e procesit të punës për hartimin e Udhërrëfyesit të ri, të mundemi të përfshijmë dhe pika të tjera.”.

Pas sugjerimeve të Kryetares, **Znj.Egro** mbështeti parimisht pikat e parashtruara dhe theksoi që të gjitha janë çështje për t'u diskutuar përpara se të vendosim. Ajo u ndal duke theksuar që Udhërrëfyesi është një Kushtetutë për të gjithë anëtarët e SHC, e për rrjedhojë sugjerimet për kalendarin e aktiviteteve nuk synojnë të mbivendosin strategji, por t'i vijnë në ndihmë zbatimit të Udhërrëfyesit. Ajo shtoi gjithashtu se përsëritja e shqetësimeve të ngritura në këtë Këshill, është tregues se disa prej çështjeve nuk kanë marrë përgjigje, prandaj elementët rregullatorë të këtij Këshilli duhen vënë në zbatim për këto çështje të pazgjidhura. Më konkretisht u ndal tek problemet fiskale të organizatave të ShC, duke theksuar që në këtë mbledhje, ndryshe nga ç'u la në mbledhjen e fundit nga Z/Ministrja e Financave që ishte e pranishme, nuk kemi të pranishëm përfaqësues me të cilët mund të diskutojmë mbi nismat qeveritare që duhen apo po ndërmerren për këtë problematikë për organizatat. Për



KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

rrjedhje, Znj.Egro sugjeroi që herën tjetër, në mbledhjen e rradhës të kemi një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Taksave, dhe që përfaqësuesit e Ministrisë së Financave të vijnë me një detyrë për këtë çështje.

Në vazhdë të diskutimeve, **Znj.Manastirtliu** sugjeroi që problematikat e parashtruara në Këshill të vijnë me relacione ose analiza përkatëse, me qëllim vlerësimin strategjik dhe më të lehtë të tyre, qasje që do e ndihmojë Këshillin në efikasitetin e vet. Gjithashtu ajo sugjeroi që anëtarët e Këshillit të jenë në koherencë edhe me proceset nëpërmjet së cilave funksionon pushteti qendror. P.sh nëse do të kemi sugjerime për ndryshime në buxhet apo për fondin social, këto diskutime duhet bërë përpara se të mbyllen nga Ministritë përkatëse me grupet e interesit. Pra tani mund të ngremë sugjerime të cilat mund të reflektohen për vitin buxhetor 2024-2025.

Në lidhje me fondin social, Kryetarja e Këshillit, shpjegoi se në bashki me marrëveshje dy-tre palëshe për proritete sipas planeve sociale të vetë bashkive mund të ndërtohen këto instrumenta bashkëpunimi mes pushtetit lokal dhe ShC, e për rrjedhje mund të përfitohet nga fondi social i cili dhe për vitin 2023 ka patur një rritje e cila është rreth 30% të buxhetit që është caktuar në 2022.

Në lidhje me këto çështje, **Z.Thano** theksoi se anëtarët e shoqërisë civile në Këshill janë anëtarë që zgjidhen dhe janë gjithashtu vullnetarë, të cilët përfaqësojnë atë fushë ekspertize që mbulojnë në përditshmërinë e tyre, nuk kanë kapacitetet dhe ekspertizën e përfaqësuesve të qeverisë, së cilëve kjo ekspertizë u rregullohet me ligj dhe u mbështetet financiarisht.

Znj. Megi Fino, Z/Ministër e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, sugjeroi që në grupet e punës të propozuar nga Z.Thano të përfshihet edhe Ministria e Brendshme, pasi nuk ishte e reflektuar në propozimet e bëra. Znj.Fino propozoi gjithashtu që në grupin e punës të përfshihet edhe Ministria e Integritimit. Në këtë rast, duke qenë se puna për integrimin është bashkëpunim midis Kryenegociatorit/Ministrit të Shtetit, i cili përfshin aspektin teknik dhe MEPJ që mbulon aspektin politik, Znj.Fino shtroi pyetjen nëse është menduar një mënyrë koordinimi për të dy këto institucione në grupin e punës, si edhe a është menduar një përfshirje e Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC) në këto grupe pune.

Z.Armando Bala, përfaqësues i Këshillit nga shoqëria civile, sugjeroi që grupit të dytë të punës t'i shtohet një raport historik se çfarë është bërë në Këshill për vitin 2022 dhe vitet e mëparshme, në mënyrë që vetë Këshilli të fillojë të punojë për shoqërinë civile.

12:05 – Znj. Ermelinda Mahmutaj vijoi me prezantimin e propozimeve për kalendarin e aktiviteteve për muajin dhjetor 2022 dhe Janar 2023⁵. Sipas

⁵ Shtojca III



KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Znj.Mahmutaj, anëtarët e Këshillit, përfaqësues të shoqërisë civile, propozuan si më poshtë vijon:

1. Organizimin e një seminari kombëtar për shoqërinë civile brenda muajit dhjetor, gjatë së cilit pritet të identifikohen prioritetet tematike për secilën fushë veprimi të Këshillit, si edhe përcaktimi I pritshmërive për Këshillin për vitin 2023.
2. Organizimi i një mbledhje koordinuese gjatë së cilës do reflektohet mbi arritjet e seminarit dhe vijueshmërinë e komunikimit e shoqërinë civile.
3. Hartimi i planit të veprimit për vitin 2023, brenda muajit janar 2023.

Znj.Manastirliu sugjeroi që përfaqësuesit e SPAK të mund të përfshihen për çështje të caktuara dhe raportime, dhe jo të jenë përfaqësues të përhershëm të Këshillit. Gjithashtu shtoi se pasi të bëhet zgjedhja e Këshillit të ri, të diskutohen dhe njëherë anëtarët e përhershëm dhe ata të përkohshëm të grupeve të punës, ku këta të fundit do të ftohen për një detyrë specifike prezantimi apo raportimi që do t'i duhen Këshillit. Kryetarja e Këshillit hodhi gjithashtu në votim ngritjen e dy grupeve të punës dhe përpilimin e planit të punës për vitin 2023, çështje e cila u votua në unanimitet.

Pas përfundimit të diskutimeve kryesore, përfaqësues të shoqërisë civile jo anëtarë të Këshillit, të cilët ishin të pranishëm në mbledhje, morën fjalën. **Z.Gjin Marku, përfaqësues i Komitetit të Pajtimit Mbarëkombëtar**, falenderoi pjesëmarrësit dhe të gjithë anëtarët për punën e bërë, si edhe theksoi se ishte kjo mbledhje e cila në një farë mënyre i bëri të ditur rëndësisinë e Këshillit për shoqërinë civile. Z.Marku ngriti gjithashtu shqetësimin për NIPT-in, i cili i pengon shoqatat që janë me status pasiv.

Mungesa e fondeve është gjithashtu shqetësim për shume organizata, e për rrjedhojë sipas tij Këshilli duhet të jetë më i fortë në këtë drejtim. Ai vuri theksin gjithashtu në mungesën e shtrimit të çështjeve të zhvillimit rural në këtë Këshill, zhvillim ky që është tejet i ngadaltë dhe pothuaj i pasukseshëm.

Në mbyllje të mbledhjes, Kryetarja e Këshillit listoi disa nga detyrat **për planin e ardhshëm të punës:**

- Brenda muajit dhjetor të zgjidhen tetë anëtarët e rinj të Këshillit, të cilëve u mbaron mandati më 26 dhjetor 2022.
- Në dy javëshin e parë të shkurtit të vendoset plani i veprimit.
- Seminari i propozuar për janar 2023, të shtyhet për një periudhë të dytë, periudhë kjo që mund të vendoset gjatë diskutimit dhe miratimit të planit të veprimit në dy-javëshin e parë të shkurtit 2023.